

**Njoftim për përqendrim me të cilin Aricoma a.s., Republika Çeke synon të fitojë
kontroll mbi Convotis Business Solutions GmbH, Austri dhe mbi SAPPHIRE
MANAGEMENT CONSULTING d.o.o Slloveni**

(lënda nr. 08-172/2025)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 26.11.2025, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin Aricoma a.s., me seli në Vinohradaska 1511/230, Strashnice, 100 00 Pragë 10, Republika Çeke, e kontrolluar plotësisht nga KKCG Group (Grupacionit KKCG), synon të fitojë kontroll të plotë mbi Convotis Business Solutions GmbH me seli në 1 Guglgasse 15/4a/kati i 4-t, 1110 Vjenë, Republika e Austrisë, dhe mbi 90% të aksioneve të SAPPHIRE MANAGEMENT CONSULTING d.o.o., informacisko in poslovno svetovanje me seli në Shmartinska cesta 56, 1000 Lubjanë, Republika e Sllovenisë.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre afariste:

Parashtruesi i Njoftimit në transaksion është Aricoma a.s., me seli në Vinohradaska 1511/230, Strashnice, 100 00 Pragë 10, Republika Çeke. Parashtruesi i Njoftimit është kompani holding që menaxhon pjesët në shoqëritë e saj të varura, veçanërisht me Aricoma Systems a.s., Sabris Consulting s.r.o. dhe Aricoma Enterprise Cybersecurity a.s. Aricoma Systems a.s. fokusohet në zbatimin e projekteve të mëdha për kompani të mëdha, implementimin dhe mbështetjen e sistemeve të informacionit të biznesit Microsoft Dynamics, si dhe ofrimin e infrastrukturës IT, aplikacioneve korporative, mbështetjen e proceseve të biznesit, kujdesin për klientët dhe sigurinë IT. Sabris Consulting s.r.o. fokusohet në ekspertizën në SAP, zgjidhjet e biznesit dhe shërbimet e ndërlidhura. Aricoma Enterprise Cybersecurity a.s. ofron teknologji për sigurinë, vlerësimin e sigurisë, shërbime për mbrojtjen kibernetike dhe këshilla për pajtueshmërinë me GDPR.

Aricoma i përket KKCG Group. KKCG Group investon në fusha të ndryshme afariste, duke përfshirë lotaritë dhe lojërat e fatit, energjetikën, pasuritë e paluajtshme dhe teknologjitë e informacionit.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, KKCG Group është e pranishme në tregun e operimit me terminale për video-lotari dhe teknologji të informacionit përmes shoqërive të mëposhtme:

- Shoqëria për organizimin e lojërave të fatit CASINOS AUSTRIA INTERNATIONAL MACEDONIA SHPK Shkup, me veprimtari prioritare - veprimtari të bixhozit dhe basteve;
- Shoqëria për organizimin e lojërave të fatit Video-lotaria Shtetërore e Republikës së Maqedonisë - CASINOS AUSTRIA SHPK Shkup, me veprimtari prioritare - veprimtari të bixhozit dhe basteve;
- Shoqëria për teknologji informatike AVENGA SHPKNJP Shkup, me veprimtari prioritare - programim kompjuterik; dhe
- Shoqëria për arsim kompjuterik dhe zhvillim të inovacioneve AVENGA Academy SHPKNJP Shkup, me veprimtari prioritare - arsim tjetër i papërmendur diku tjetër;

- Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime Musala Soft SHPKNJP Shkup - me veprimtari prioritare - programim kompjuterik.

Convotis Business Solutions ka si veprimtari prioritare ofrimin e shërbimeve për implementim, konsulencë, mbështetje dhe trajnim për sistemet SAP ERP. Shërbimet e ofruara përfshijnë konsulencë për cloud dhe transformim, punë me sisteme SAP, integrim sistemesh dhe shërbime të tjera të lidhura me SAP.

SAPPHIRE MANAGEMENT CONSULTING d.o.o., informacijsko in poslovno svetovanje ka si veprimtari prioritare ofrimin e shërbimeve për implementim, konsulencë, mbështetje dhe trajnim për sistemet SAP ERP. Shërbimet e ofruara përfshijnë konsulencë për zgjidhje cloud dhe transformim, punë me sisteme SAP, integrim sistemesh dhe shërbime të tjera të lidhura me SAP.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të dorëzojnë vërejtje dhe mendime për këtë përqendrim në Komision. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr. 54, Shkup ose me e-mail: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision në afat prej 10 ditësh nga dita e shpalljes së këtij njoftimi.

28.11.2025

Shkup